

Rregullat gjatë testimit të gjuhës angleze

Ju lusim t' i lexoni me kujdes rregullat më poshtë. Nëse keni ndonjë pyetje rreth këtyre rregullave, pyeteni përgjegjësën e sallës për sqarime shtesë, para se të fillojë testimi.

1. Mbi tavolinë ju lejohen vetëm lapsi kimik, letërnjoftimi, dezinfektuesi për duar dhe një shishe ujë.
2. Sigurohuni që i keni dorëzuar të gjitha pajisjet elektronike teksa keni hyrë në sallën e testimit. Çdo pajisje elektronike që gjendet tek ju pas fillimit të testit do të rezultojë në diskualifikimin tuaj nga testi.
3. Mbajtja e maskës duke e mbuluar gojën dhe hundën është e obligueshme. Në rast se nuk e mbani maskën siç duhet (duke mbuluar gojën dhe hundën), përgjegjësi i sallës mund t'ju kërkojë të dilni nga salla dhe si rezultat mund të diskualifikoheni nga testi.
4. Testi zgjat **45 min**. Përgjegjësi i sallës do t'ju informojë për kohën e mbetur deri në përfundim të kohës së paraparë për test duke filluar nga 15 minutat e fundit, si ndihmë për menaxhimin e kohës suaj.
5. Testi përbëhet nga materiali testues dhe fletëpërgjigja (answer sheet). **Vetëm përgjigjet tuaja në fletëpërgjigje do të kontrollohen. Nuk keni kohë shtesë për transferimin e përgjigjeve nga materiali testues në fletëpërgjigje**, prandaj sigurohuni që t' i transferoni përgjigjet tuaja gjatë testimit.
6. Testi i ka 20 pyetje.
7. Sigurohuni që të gjitha përgjigjet në fletëpërgjigje (answer sheet) të jenë përgjigjet e juaja përfundimtare. Nëse e korrigjoni ndonjë përgjigje apo përdorni shkrim jo të qartë, përgjigjet e tilla konsiderohen automatikisht të pasakta.
8. Shkruani përgjigjet tuaja në fletëpërgjigje me **laps kimik**. Përgjigjet me laps nuk do të pranohen.
9. **Nuk** lejohet të bëni pyetje gjatë provimit. Të gjitha informacionet e nevojshme janë në udhëzimet e detyrave në test, prandaj lexoni udhëzimet me kujdes.
10. **Mos** flisni gjatë testit dhe mos i shqetësoni kandidatët tjerë që janë duke u testuar.
11. Nuk mund të kërkontë ta përdorni toaletin gjatë provimit. Nëse dilni nga salla gjatë testit, do të diskualifikoheni nga testi.
12. Duhet të qëndroni ulur deri sa të përfundojë provimi. Nëse e përfundoni testin më herët se koha e përcaktuar për testim, qëndroni ulur në ulësen tuaj dhe kthejeni materialin testues dhe fletëpërgjigjen në faqen e fundit, e cila është fletë e zbrazët. Mund të dilni nga salla e testimit vetëm kur t'ju udhëzojë përgjegjësi i sallës.
13. Çfarëdo përpjekje për të kopjuar gjatë testimit, apo çfarëdo ndihme që ua ofroni kandidatëve të tjerë, me apo pa dijeninë tuaj, do të rezultojë në diskualifikimin e testit tuaj.
14. Në fund të provimit, duhet ta dorëzoni materialin testues dhe fletëpërgjigjet. Mbajtja e çfarëdo materiali testues dhe/apo shpërndarja e atij materiali është shkelje serioze e rregullave të testit dhe për këtë do të penalizoheni.